

LIGJ
Nr.7752, datë 28.3.1993

PËR POLICINË E NDËRTIMIT

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Krijohet Policia e Ndërtimit, si organ ekzekutiv i armatosur dhe i specializuar për kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë në fushën e ndërtimit dhe të urbanistikës.

Neni 2

Policia e Ndërtimit varet nga ministri i Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit.
Ajo përbëhet nga Drejtoria e Policisë së Ndërtimit dhe degët e saj në rrethe, të cilat zbatojnë vendimet e Këshillit të Rregullimit të Territorit të Rrethit.

KREU II
TË DREJTAT E POLICISË SË NDËRTIMIT

Neni 4

Policia e Ndërtimit ka të drejtë të kontrollojë:

1. Licensat e personelit teknik të punimeve ndërtimore;
2. Dokumentacionin teknik të objektit për:
 - ligjshmërinë e projektzbatimit;
 - çertifikatat e kontrollit të materialeve;
 - çertifikatën e kolaudimit;
 - lejen e shfrytëzimit të ndërtimit;
3. Hartimin dhe zbatimin e projektit në përputhje me kushtet teknike të projektimit dhe zbatimit;
4. Zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjen në punë;
5. Shenjat e prodhimit të elementëve të parafabrikuar që përdoren në ndërtim;
6. Depozitimimin në vendin e caktuar dhe largimin e mbeturinave ndërtimore nga objekti që ndërtohet.
7. Dokumentacionin e dhënies së sheshit të ndërtimit;
8. Lejen e ndërtimit, afatin dhe fazat e zbatimit të saj;
10. Destinacionin e përdorimit të objektit;
11. Leje për prerje dhe shkulje drurrësh;
12. Leje për prishje ndertesash;
13. administrimi i sipërfaqeve të gjelbërta;
14. Zbatimin e Vendimeve të bazuara në ligj që organet lokale marrin në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës.

Policia ndërtimore ka këto të drejta:

- a) Të kontrollojë në çdo kohë në kantieret e ndërtimit, njësitë e prodhimit, magazinimit e të

shitjes së materialeve të ndërtimit, si dhe në laboratorët e zyrat projektuese shtetërore e private, për të marrë dhe për të verifikuar të dënat e nevojshme për zbatimin e këtij ligji.

b) Të kërkojë nga personat fizikë e juridikë, vendas e të huaj vënien në dispozicion të të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për ushtrimin e kontrollit sipas nenit 4.

c) Pezullojë punimet ndërtimore kur konstaton shkelje të pkave të nenit 5.

ç) Të vendosë gjoba për shkelje në dispozitave të këtij ligji.

d) Të bëjë prishjen e ndërtimeve pa leje apo të kundërligjshme në çdo fazë të procesit të punimeve, në bazë të vendimit të këshillit të rregullimit të territorit të rrethit.”

Neni 5

Quhet kundërvajtje administrative në kuptim të këtij ligji:

1. Projektimi, zbatimi, drejtimi dhe kolaudimi i punimeve të ndërtimit nga persona të papajisur me licencë jo në përputhje me kategorinë e punimeve që kryen.

2. Mosnjoftimi apo njoftimi me vonesë për fillimin e punimeve ndërtimore dhe mosparaqitja e dokumentacionit përkatës në zyrën e urbanistikës nga zbatuesi i punimeve.

3. Lejimi nga drejtori i punimeve i realizimit të punimeve ndërtimore në kundërshtim me projektin dhe kushtet teknike në fuqi.

4. Mosparaqitja në zyrën e urbanistikë e certifikatës së kolaudimit nga kolaudatori.

5. Përdorimi i ndërtimeve pa certifikatën e kolaudimit.

Këto kundërvajtje dënohen me gjoba nga 10.000 deri në 100.000 lekë.

6. Depozitimi i mbeturinave ndërtimore jo në vendin e përcaktuar në lejen e ndërtimit dhe moslargimi i tyre.

7. Shkelja e afatit të lejes së ndërtimit.

8. Prerja apo shkulja e drurëve pa leje kur vlefte e dëmit është deri në 5.000 lekë.

9. Prishja e ndërtesave ekzistuese pa leje.

10. Ndërhyrjet në sipërfaqet e gjelbërta të qytetit.

Këto kundërvajtje dënohen me gjobë deri në 10.000 lekë.

11. Mosndërtimi i rrethimeve të përkohshme në objektin që ndërtohet.

12. Ndryshimi i destinacionit të objektit pa lejen e organeve përkatëse.

Këto kundërvajtje dënohen me gjobë deri në 5.000 lekë.

13. Ndërtimet pa leje në sheshin e miratuar dënohen me gjobë deri në 50.000 lekë dhe pezullim të punimeve. Me vendim të këshillit të rregullimit të territorit të rrethit, Policia e Ndërtimit bën prishjen e objektit me shpenzimet e kundërvajtësit.

14. Zënia arbitrare e truallit për ndërtim dënohet me gjobë deri në 100.000 lekë, me prishjen e objektit dhe kthimin e truallit në gjendjen e mëparshme me shpenzimet e kundërvajtësit.

15. Ndërhyrjet pa leje në rrjetin e infrastrukturës dhe burimet e ujit të pijshëm dënohen me gjobë deri në 100.000 lekë dhe kthimin e rrjetit në gjendjen e mëparshme me shpenzimet e kundërvajtësit.

Dënimet për kundërvajtje administrative jepen nga punonjësit e degëve të Policisë së Ndërtimit në rrethe dhe të Drejtorisë së Policisë së Ndërtimit në Ministrinë e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit.

Neni 6

Policia e Ndërtimit bashkërendon punën me organizmat përkatëse të specializuara në organet e pushtetit lokal.

Neni 7

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankimi brenda 5 ditëve nga data e njoftimit tek kryetari i degës së Policisë së Ndërtimit në rreth ose tek drejtori i Policisë së Ndërtimit.

Kundër vendimeve të këtyre organeve mund të bëhet ankimi ose protestë brenda 5 ditëve nga dita e shpalljes ose njoftimit në gjykatën e rrethit ku është kryer kundërvajtja, vendimi i së cilës është i formës së prerë.

Neni 8

Gjobat, të ardhurat dhe shpërblimi i dëmit paguhet nga kundërvajtësit brenda 5 ditëve, nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afati, për çdo ditë vonesë, paguhet kamatë 2 për qind deri në 1 muaj. Kur edhe pas këtij afati nuk paguhet, zbatimi bëhet nëpërmjet qendrës së punës së kundërvajtësit, duke përfshirë edhe punëdhënësit privatë. Kur gjoba nuk paguhet ose nuk nxirret dot nga paga, zbatohet ligji për nxjerrjen e të ardhurave shtetërore.

KREU III DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 9

Policia e Ndërtimit, për kryerjen e detyrave të saj, bashkëpunon me organet e ruajtjes së rendit. Armatimi i saj përcaktohet nga Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Rendit Publik.

Neni 11

Në shërbim të Policisë së Ndërtimit pranohen shtetasit që plotësojnë këto kërlesat:

- të jenë shtetas shqiptarë;
- të kenë kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak;
- të kenë të paktën arsim profesional ndërtimi të mesëm;
- të mos jenë dënuar për krime kundër pasurisë shtetërore e private, për krime kundër moralit dhe kundër personit;
- të jenë të aftë nga ana fizike e mendore.

Neni 12

Këshilli i Ministrave miraton strukturën dhe fondin e pagave për policinë e ndërtimit.

Neni 13

Të gjitha dispozitat që bien në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas shpalljes së tij.

Shpallur me dekreten nr.656, datë 11.10.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.